

BASHKIA KUKES
NJËSIA E PROKURIMIT

Data: 19.08.2025

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës – Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e procedurës)

I mbajtur sot më datë 18.08.2025, në Bashkinë Kukës, nga Njësia e Prokurimit, e përcaktuar në urdhrin e prokurimit nr. 1128, datë 23.07.2025, të titullarit të autoritetit kontraktor, në lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, për procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme :

Objekti i kontratës : “Menaxhimi i trafikut rrugor “Sinjalistika Horizontale dhe Vertikale e Qytetit të Kukësit” me **REF-58424-08-19-2025**

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): **34928470-3/Sinjalistike**.

Fondi limit: 8,748,151(tete milion e shtateqind e katerdhjete e tete mije e njeqind e pesedhjete e nje) Leke pa TVSH vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:

Afati kohor për shërbimin sipas objektit të prokurimit do të jetë duke filluar nga data e lidhjes së kontratës brenda ose 2 (dy) muaj kalendarike.

Data e zhvillimit të procedurës: 29.08.2025 ora 11.00 ne www.app.gov.al

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Kukës (Njësia e Prokurimit), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë :

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*
- b. *Formulari i ofertës sipas shtojcës nr.2*
- c. *Formulari i sigurimit të ofertës sipas shtojcës nr.3*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 ”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i

ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar) si dhe ne mbështetje te Nenit 26 ”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar):

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 10 dhe shtojca nr.3).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas **shtojcës 10 të DST**.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *”Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, ”Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”,* si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

Ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se dyfishi i fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Akt i kolaudimit
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacion/faturë tatimore;
- Dhe çdo lloj dokumenti tjetër që provon realizimin me sukses të punëve;
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe Prokurën e posaçme, të deklaruara në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin nga ana e Autoritetit Kontraktor.

(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë pesë viteve të fundit, të jenë minimalisht për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se vlera limit e kontratës që prokurohet, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Staf teknik:

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë lëshuar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

Punonjës Staf Teknik

- Ing. Ndertimi 1 (nje)

•1 (një) inxhinier ndërtimi: Prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses, mbikëqyrjen teknike dhe përgatitjen e zbatimit të punimeve betoni, hekurbetoni dhe rifiniturës.

Për të cilët operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat e punës,
- Librezën e punës përkatëse dhe
- Jetëshkrimi (CV).

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të ofertave ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 10, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi : Kërkesat pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.3 Përveç sa më sipër duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e vet minimalisht 15 (pesëmbëdhjete) punonjës, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për një periudhë të paktën 3 Muaj nga data e hapjes së procedurës, ku të ketë punonjës me profesionin si më poshtë:

-	Teknik ndërtimi	1 (një)
-	Topograf	1 (një)
-	Manovrator	2 (dy)
-	Shofer	2 (dy)
-	Punëtorë ndërtimi	8 (tete)
-	Punëtorë të thjeshtë	1 (një)

Gjithsej: **15 punonjes (pesëmbëdhjete)**

Për të cilët operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Kontratat e punës dhe dëshmia profesionale përkatëse, Formularët E- SIG për periudhën 3 muajt e fundit si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të ofertave ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 10, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- **1 (një) teknik ndërtimi:** prezenca e tij është e nevojshme për asistencë teknike dhe koordinim gjatë zbatimit të punimeve ndërtimore.
- **1 (një) topograf:** kjo kërkesë përputhet me nevojën që lind nga projekti dhe elementet ndërtimore të cilat kërkojnë përgatitje të terrenit dhe matje topografike për saktësi.
- **2 (dy) manovrator:** referuar volumeve të punës si dhe mjeteve të nevojshme si ekskavator, autovinc, betoniere për punët që do të realizohen të cilat kërkojnë manovrim profesional.
- **2 (dy) shoferë:** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, referuar volumeve të punës si dhe mjeteve të nevojshme për punët që parashikojnë transportin e materialeve ndërtimore dhe dherave ose inerteve.
- **8 (tete) punëtorë ndërtimi:** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen për kryerjen e punimeve ndërtimore.
- **1 (një) punëtorë të thjeshtë:** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen për kryerjen e punimeve ndërtimore të përbashketa, mbjellje dhe mirembajtje të terrenit.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të ofertave ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 10, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit

26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi : Kërkesat pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Argumentimi që drejtuesi teknik të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për një periudhë të paktën 3 Muaj nga data e hapjes së tenderit, është gjykuar nga AK, për tu siguruar që operatorët ekonomik kanë një konsolidim ose qëndrueshmëri të stafit, për arsye të besueshmërisë në realizimin me sukses të kontratës .

Specialistët e mësipërm, janë përcaktuar në përputhje me projekt-preventivin, volumin e proceseve të punës. Pra janë vendosur kërkesa të cilat lidhen ngushtë aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Dëshmia profesionale dhe dëshmia kualifikimit të sigurimit teknik, janë kërkuar nga AK për t’u siguruar në aftësitë e specialistëve për zbatimin korrekt të punimeve si dhe që këta specialistë kanë njohuritë e duhura për rregullat e sigurimit teknik në punë.

Arsyeja që specialistët të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për një periudhë të paktën 3 Muaj nga data e hapjes së tenderit, është gjykuar nga AK, për t’u siguruar që operatorët ekonomik kanë një konsolidim ose qëndrueshmëri të stafit, për arsye të besueshmërisë në realizimin me sukses të kontratës. Numri prej 15 punonjës është konsideruar i pranueshëm në përputhje me volumin e punimeve dhe afatin e realizimit prej 2(dy) muaj kalendarike.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- NP–1 – Punime gjurmimi në tokë
- NP–2 – Ndërtime civile dhe industrial

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- NS –6 – Punime Sinjalistika rrugore jondriçuese .

Kategoria e kërkuar	Niveli i klasifikimit i kërkuar për	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të	Kategoritë me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv	Vlerat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv,
---------------------	-------------------------------------	---	---	---

	kategorinë respektive	fushës		që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	A	Punime gjërmimi në tokë	- Gjermim dhe me eskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi > 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet - Hedhje ,rrafshim ,mbushje dhe me krah, kategoria III - Mbushje me material të gjërmuar në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri - Skarvim shtrese asfalti ekzistuese me makineri - Mbjellje bari në skarpat	0-20,000,000 lekë
NP-4	A	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tranvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	- Trotuar me pllaka, pa bordurën e betonit - Bordura Betoni 12 x 25 cm - Tapet Betoni - Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 4 cm, me makineri	0-20,000,000 lekë
NS-6	A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese	- Vijëzimet e kalimit të këmbësorëve. Bikomponente (sprajt) - F.V.Tabela të ndryshme rrugore D = 90cm - F.V. Tabele rrethi “detyrim” normal me D = 60 - F.V. Tabela rrethi “ndalim” normal me D = 60 - F.V. Tabela katrore normal me A = 60 - F.V. Tabela drejtkëndore	0-20,000,000 lekë

			(tregimi) (AxB) normal 90x135 - F.V. Tabela drejtkëndore (tregimi)(AxB) e madhe 135x200 - F.V. Tabela trekëndore e vogël me A = 60 - F.V. Tabela trekëndore normal me A = 90 - F.V. Tabela tetëkëndore e vogël me A-B, 60-20	
--	--	--	--	--

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar,

Licencat për punimet speciale të ndërtimit janë kërkuar bazuar në zërat e punimeve të preventivit , referuar vlerave të preventivuara për këtë kategori licence. Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi **A** (edhe për herë të parë) 0 - 20 milion lekë.

- 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik si më poshtë:**

MAKINERI / PAJISJE PUNE

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
-----------	---------------------------	-----------------	---------------	--------------

1	Ekskavator	Në pronësi, me qira ose me kontratë bashkëpunimi	Copë	1
2	Auto vetëshkarkuese deri në 10 km	Në pronësi, me qira ose me kontratë bashkëpunimi	Copë	1
3	Spërkatës boje për vijëzime në rrugë	Në pronësi, me qira ose me kontratë bashkëpunimi	Copë	2
4	Auto-vinç	Në pronësi, me qira ose me kontratë bashkëpunimi	Copë	1
5	Autobitumatriçe	Në pronësi, me qira ose me kontratë bashkëpunimi	Copë	1
6	Asfaltshtruese	Në pronësi, me qira ose me kontratë bashkëpunimi	Copë	1
7	Rul (kompresor) me vibrim	Në pronësi, me qira ose me kontratë bashkëpunimi	Copë	1
8	Makineri për skarifikim shtresash rrugore	Në pronësi, me qira ose me kontratë bashkëpunimi	Copë	1
9	Betoniëre	Në pronësi, me qira ose me kontratë bashkëpunimi	Copë	1

- **1 (një) ekskavator me goma:** Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen për gërmimin e shtresave të dheut.
- **1 (një) auto vetëshkarkuese deri 10 km:** Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të nevojiten për transportin e materialeve ndërtimore dhe dheut.
- **1 (një) betoniëre:** Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës për përzierjen dhe hedhjen e betonit në vend.
- **2 (dy) Spërkatës boje për vijëzime në rrugë:** Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të nevojiten për vizimet në rrugë.
- **1 (një) Autobitumatriçe:** Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës për shtrimin e bitumit të nxehtë mbi shtresën e bazës.
- **1 (një) Asfaltshtruese:** Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës për sigurimin e një sipërfaqe të rrafshët dhe kompakte para rulimit.
- **1 (një) Rul (kompresor) me vibrim:** Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës për ngjeshjen e shtresave të bazës (zhavorr, stabilizant) para asfaltimit.
- **1 (një) Auto-vinç 4 - 6 Ton:** Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës për ngritjen dhe zhvendosjen e ngarkesave të rënda si; bordura, tabela etj.

-Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të subjektit, duhet të paraqiten kontratat e shitblerjes dhe/ose faturat tatimore, ndërsa kur janë të marra me qira duhet të paraqiten kontrata e qirasë, faturat tatimore dhe kontrata e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit më sipër (për rastet e faturave të biznesit të vogël) duhet të shoqërohen me kuponin tatimor.

-Për automjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, vërtetimi i pagesës për taksat vjetore, siguracioni dhe fotot përkatëse, ndërsa për automjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.

-Për automjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimit dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për automjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.

-Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se: Makineritë dhe pajisjet e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. Kjo deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese duhet të përmbajë vendndodhjen e saktë të mjeteve në pronësi ose me qira me qëllim verifikimi.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të ofertave ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 10, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të autorizuar/akredituara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë:

➤ Certifikate: EN ISO 9001: 2015 “Per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise ose ekuivalente “

Shënim: Çertifikatat ISO të jenë të vlefshme edhe nëse plotësojnë standarte shqiptare të konformitetit.

Çertifikimet e mësiperme duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer e të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj, të jenë të vlefshme, si dhe duhet të plotësohen nga secili prej anëtarëve në rast të ofertës nga bashkim operatorësh, përveç çertifikimeve të cilat lidhen me procese të veçanta të cilat duhet të plotësohen në përputhje me zërat/proceset e marra përsipër në bashkëpunim

* Të gjitha çertifikatat e mësiperme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësiperme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe neni neni 44 “Kërkesa e cilësisë” pika 1, 3.. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standard që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Certifikatat kërkuara më sipër janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke mbajtur në konsideratë parimin e mosdiskriminimit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë për bojrat, fosforin, adezivin dhe tabelat, katalogun dhe/ose skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike ose të paraqesë specifikimet teknike në formë tabelore në një deklaratë. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Vendorsja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Bashkia Kukes

Afati për realizimin e kontratës: Afati kohor për shërbimin sipas objektit të prokurimit do të jetë duke filluar nga data e lidhjes së kontratës brenda ose **2 (dy) muaj kalendarike**.

Specifikimet dhe relacioni teknik bashkëlidhur këtij procesverballi.

Kriteret e veçanta, (Kapaciteti Teknik) janë hartuar nga Ing. Perkates pjese e njesise se prokurimit.

Njësia e Prokurimit